



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:170115

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06786382

2023:170116

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.H. nga Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.927/2023, të datës 08.08.2023, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor publik më datë 08.01.2025, në prani të prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të dëmtuarit e përfaqësuesit të tij me autorizim av.Bekim Sylejmani, të pandehurit dhe po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 31.01.2025 e përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri R. H., nga i ati Sh. dhe e ëma F. e gjinisë N., i lindur më në ..., me vendbanim në rrugën “...” nr..., në, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor ne boten e jashtme, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal, i pa dënuar me parë, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë proceduar tjetër penale.

S E P S E

Sepse me 19.05.2023, rreth orës 14:00, në rrugën “....” në, saktësisht tek “ ”, i pandehuri pas një mosmarrëveshje dhe fjalosje momentale lidhur me lëvizje në komunikacion me dashje dhe me qëllim të dëmtimit të integritetit trupor e ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin, në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari kishte parkuar veturën e tij aty kishte shkuar i pandehuri ku fillimisht ju kishte drejtuar me fjalët se “A e pave që keve tum rrok, prekum edhe një her se të kallxoj” dhe i dëmtuari i kishte thënë jo bre se keve shumë largë dhe kishte filluar ta kaloj rrugën i pandehuri kishte vrapuar pas dhe e kishte goditur tri herë me grushta në kokë, fytyrë dhe në veshin e majtë, me ç’rast si pasoj e këtyre goditjeve i dëmtuari P. R. pëson lëndime të lehta trupore me pasoja të përkoshëme për shëndetin dhe atë: ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të regjionit të mollëzës të faqes së majtë të fytyrës, të regjionit të mjekrës, plagë shqyrëse-ndrydhëse të laprës të veshit të majtë, të përshkruar si në Akt-Ekspertimin mjeko-ligjor, me numër të referencës 04/2023 të datës 30.07.2023.

Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nen par 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjyqtari i vetëm gjykues, në kuptim të nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe 185 par 1 të KPRK-së, si dhe neneve 364 dhe 449 par. 2.6 dhe 2.9 dhe nenit 462 të KPPRK-së, të akuzuarën e:

G J Y K O N

Me dënim me gjobë, në shumë prej 400 € /katërqind euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t’i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro (njëzet euro), për shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjeko ligjore) në shumë prej 20 € / njëzet Euro si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 20 /njëzet/ Euro, që të tri shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

I dëmtuari P. Nj. R. nga, rruga ”.....” për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore ne Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II. nr.927/2023, të datës 08.08.2023, kundër të akuzuarit për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nen par 1.4 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe t’i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 08.01.2025, në të cilën seancë kane prezantuar prokurori i shtetit, i dëmtuari e përfaqësuesi i tij dhe pandehuri.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të pandehuri për të drejtat e tija në kuptim të nenin 241 par.1 të KPPRK-së, dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me neni 241 paragrafi 4 të KPPRK-së, i ka afruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është i akuzuar.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale që më ngarkon aktakuza, jam i njoftuar me pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajit e bëj në mënyrë vullnetare, ndihem thellë i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, i kërkoj falje publike te dëmtuarit, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të tillë apo të ngjashme, andaj lus gjykatën që mua të më shqiptoj një dënim sa më të butë që është e mundur.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit deklaroi, nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi që një pranim të tillë u bë vullnetarisht nga i pandehuri. I propozoj gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ndërsa me

rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 69 dhe 70 e KPRK-së.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit av. Bekim Sylejmani lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaron nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që është bërë konform dispozitave të KPP, i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe paraqesim kërkesë pasurore- juridike.

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaron: e mbështet në tërësi fjalën e përfaqësuesit –avokatit.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Procesverbali i marrjes në pyetje i të dëmtuarit-dëshmitarit P. R. dhënë në SP në Ferizaj, me datë 19.05.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurit R. H. dhënë në SP në Ferizaj me datë 19.05.2023, Procesverbali i marrjes në pyetje i dëshmitarit Sh. H. të dhënë në SP në Ferizaj me datë 24.05.2023, Raporti i oficerit G. S. me numër të rastit 2023-CF-1059 i datës 19.05.2023, Raporti i oficerit A. R. i datës 15.05.2023, Raporti i oficerit policor S. M. i datës 19.05.2023, Raporti i policit hetues I. B. me numër 2023-CF-1059 i datës 30.06.2023, Raporti fillestar i incidentit me numër 2023-CF-1059, i datës 19.05.2023, Zinxhiri i ruajtjes i datës 19.05.2023, Vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht i datës 16.06.2023, Raporti mjekësor i lëshuar nga QKMF Ferizaj i datës 19.05.2023, Akt ekspertimi mjeko-ligjor me numër referencës::04/2023 të datës 30.07.2023, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 242, paragrafi 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. (*nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nen par 1.4 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe i pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri e ka bërë pranimin e fajësisë, duke e shprehur pendimin e singertë dhe të thellë dhe keqardhjen për veprën penale të kryer, kërkim faljen publike, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit veprën të tillë apo të ngjashme, se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, ndërsa rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethana të kryerjes, rrezikshmërisë së saj dhe autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi kërkesës pasurore-juridike, është marruar në kuptim të nenit 462 par 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë dhe të procedurës, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2023:170116, datë 31.01.2025**

**Zyrtarja Ligjore
Kimete Bytyqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues:
Imri Sejda**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.